

REPUBLIKA E SHQIPERISE
Këshilli i Ministrave

VENDIM

Nr. 634 datë 21 11 2001

PER

NJE NDRYSHIM NE VENDIMIN NR.775, DATE 28 10 1996, TE KESHILLIT TE MINISTRAVE, "PER KRIJIMIN E KESHILLIT KOMBETAR TE UJIT", NDRYSHUAR ME VENDIMIN NR.77, DATE 2 3 2000, TE KESHILLIT TE MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr.8093, datë 21.3.1996 "Për rezervat ujore", me propozimin e ministrit të Punëve Publike dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.775, datë 28 10 1996, të Këshillit të Ministrave, ndryshuar me vendimin nr.77, datë 2 3 2000, të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 të ndryshohet si më poshtë vijon:

"2. Këshilli Kombëtar i Ujit (KKU) përbëhet nga 10 anëtarë:

Kryeministri	kryetar;
Ministri i Punëve Publike dhe Turizmit	zëvendëskryetar;
Ministri i Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit	anëtar;
Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit	anëtar;

Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit	anëtar;
Ministri i Financave	anëtar;
Ministri i Transportit	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	anëtar;
Ministri i Mjedisit	anëtar;
Ministri i Shtetit për Energjetikën	anëtar;
Drejtor i sekretariatit teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit	sekretar."

2 .Vendimi nr77datë 2 3 2000, i Këshillit të Ministrave, "Për një ndryshim në vendimin nr.775, datë 28 10 1996, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e Këshillit Kombëtar të Ujit" shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI
ILIR META

MINISTRI I PUNEVE

PUBLIKE DHE TURIZMIT

BASHKIM FINO